



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:255795  
Datë: 11.01.2024  
Numri i dokumentit: 05176603

**C-IV-15-1754**

**Paditës:** S S nga fshati C Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati B I nga Prishtina.

**Kundër**

**Të paditurës:** Ndërmarrja Shoqërore „Magjistrala” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. ”Agim Ramadani”, nr. 23.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me gjyqtari Hasim Sogojeva, më dt. 09. 01.2024, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** si e bazuar pjesërisht padia/ ankesa e paditësit, ndryshohet vendimi i Autoritetit Likuidues PRN 032 - 0266, dt. 31.05. 2013, dhe obligohet e paditura NSH „Magjistrala”, që paditësit S S t’ ia paguaj pagat e pa paguara për periudhën nga muaji janar të vitit 2006 deri në muajin janar të vitit 2007, shumën neto 3,224.00€, pastaj të paguaj kamatën në lartësi 10 % të shumës themelore si dhe për shpenzime të procedurës në shumën 124.00€, sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 03 korrik 2013, pranë DHPGJS është parashtruar padia grupore në të cilën si paditës është edhe S S , kundër të paditurit në lidhje me Vendimin e Autoritetit Likuidues ( AL ) për NSH „Magjistrala ” PRN 032- 0266, dt. 31.05. 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme pjesërisht kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara, në shumën 3,201.16€.

Kjo lëndë ka pasur shenjë C- IV – 13- 1216, por që sipas Urdhrit të Gjykatës kjo lëndë grupore është ndarë si lëndë e veçantë dhe ka marrë numrin, C-IV- 15- 1754.

Paditësi në padi, dhe në parashtrësë të plotësimit të padisë, dt. 30 shtator 2015, ka theksuar se paditësi kishte kërkuar pagat e pa paguara për periudhën e vitit 2006, deri në dhjetor të vitit 2007, në shumën 3,224.00€ , por e cila është refuzuar pjesërisht si e pa pranueshme .

I autorizuari i paditësit ka theksuar se padinë kundër Vendimit të AL PRN 032- 0266, e kishte ushtruar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale .

I autorizuari i paditësit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka deklaruar se e paditura me rastin e vendosjes për kërkesën e paditësit nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie pune te i padituri, dhe kjo e fundit ka pasur për obligim të paguaj të gjitha pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH –së , ashtu siç premtuhej edhe me dokumentin njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës .

I autorizuari i paditësit thekson se Autoriteti i Likuidimit me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, Vendimin e vetë e mbështet në të dhënat e kërkuara nga Banka Ekonomike në Prishtinë, dt. 22.05.2013, si informata për historikun e llogarisë së Paditësit , për periudhën janar 2005 – prill 2007, dhe thuhet nga përgjigja e Bankës, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk figuron në listën e pagave të NSH -së si një punëtor i saj. Më tej vendimi i AL me rastin e refuzimit të kërkesës është mbështetur në dispozitën e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

I autorizuari i paditësi ka theksuar se Banka Ekonomike nuk është institucion që lëshon apo ruan dhe mban listën e pagave, të punëtorëve dhe se pikërisht lista e pagave duke filluar nga janari i vitit 2006 deri në prill të vitit 2007, është si provë që vërteton borxhin dhe lartësinë sepse ajo është lëshuar nga personat kompetent të NSH-së .

I autorizuari i paditësit në lidhje me zbatimin e gabuar të drejtës materiale thekson se Autoriteti i Likuidimit, Vendimin e ka bazuar në dispozitën e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, kur thekson se kërkesa është e pa vlefshme dhe jo e rregullt , por duket se kjo dispozitë më shumë mekanikisht është futur në vendim, kur dihet se kërkesa është ushtruar brenda afatit dhe e provuar me dokumentacionin e lëshuar nga e paditura .

Në lidhje me kamatën është deklaruar, Ligji për AKP-në me nenin 37.3 , e rregullon këtë situatë juridike, ashtu që kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatën në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit për likuidim me kusht që ajo të mos tejkalon 10 % , e shumës themelore.

Ka kërkuar që Gjykata të miraton si të bazuar padinë, dhe të anulohet vendimi i të paditurës PRN 032- 0266 dhe të obligohet AKP-ja Autoriteti i Likuidimit për NSH „ Magjistrala ” për pagat e pa paguar të paguaj shumën 3,224.00€, si dhe kamatën ligjore .

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Më dt. 18.05.2023, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër C- IV- 15- 1754 , si për paditësin ashtu edhe për të paditurin .

Më dt. 29.05.2023, i autorizuari i paditësit dorëzoi parashtrësën me të cilën është deklaruar për rrethanat faktike dhe juridike të kërkesës së paditësit. Në parashtrësë është deklaruar se e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënia pune te e paditura deri në ditën kur ju është lëshuar Letër pezullimi , Sipas njoftimit është theksuar se „Shuma e pagave , duke përfshirë të gjitha rrogat e pa paguara të cilat ende ua ka borxh , Punëdhënësi sipas kontratës së punësimit, do ti trajtoj në përputhje me procedurat e likuidimit ” . Më tej ka theksuar se bazuar në listën e pagave, vërtetohet se paditësit ju kanë mbetur borxh nga NSH-ja, pagat e pa paguara dhe kjo dëshmohet me listat e pagave . Këto lista specifikojnë lartësinë pagës . Me këto

lista paditësi është i regjistruar me nr. 22, ndërsa në rubrika janë përshkruar detajet e borxhit, për periudhën e caktuar që është në shumën 3,224.00€. Listat janë hartuar dhe nënshkruar nga personat kompetet të NSH –së. Lista është e dorëzuar në AKP, më dt. 16.07.2007 .

Në parashtrësë është deklaruar se kundërshtimi i të paditurit duke u thirr në dispozitën e nenit 37 paragrafi 9.2, të Shtojcës së ligjit, nr. 04/L-034, nuk është sqaruar ky fakt nga Autoriteti i Likuidimit .

Me këtë parashtrësë ka dorëzuar :

- Vendimin e AL PRN 032- 0266, dt. 31.05.2013,
- Njoftimin e lëshuar nga AKM, dt. 22.05.2007,
- Formulari i kërkesë kreditore,
- Kopja e Librezës së punës,
- Listat e pagave për NJP në Gjilan, periudhën e muajit Janar të vitit 2006 deri prill të vitit 2007 ,
- Parashtrësja dt. 16.07.2007, e dorëzuar në Zyrën Rajonale në Prishtinë të AKM-së, nga drejtori ,
- Deklaratë nën betim e dhënë nga drejtori Sh P dhe Llogaritari A K , te noteri B Xh,
- Kontrata e punës,
- Dokumenti Referencë , dt. 16.07.2007,
- Dokumenti , Aktvendim dt. 21.06.2007,
- Regjistri i punëtorëve dhe të dhënat e tyre për NJP , „Magjistrala ” në Prishtinë dt.13.04.2007, dhe
- Kopja e padis bazë .

Më dt. 08.06.2023, AKP- ja përmes përfaqësuesit me parashtrësë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj pretendimeve në padinë e paditësit , kundër Vendimit PRN 032-0064, me propozim që ankesa të refuzohet si e pa papranueshme dhe ose / të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimin e Autoritetit të Likuidimit .

AKP-ja, në parashtrësë të mbrojtjes ka pohuar faktin se NSH „ Magjistrala ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 13.04.2007, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë për pagat e pa paguara, më dt. 12.07. 2007, në shumën 3,224.00€ .

Autoritetit i Likuidimit (AL) ka marrë Vendim PRN 032 - 0064, me të cilin e ka pranuar pjesërisht kërkesën e parashtruesi, ka pranuar shumën 22.84€, dhe ka refuzuar shumën 3,201.16€ .

AKP-ja , pretendon se Vendimi i AL është i bazuar në faktet dhe bazat ligjore si në vijim :

- i) Neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 , parashikon „ elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë ..kërkesa ose pretendimi është i pasafatëshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme ” .
- ii) Neni 608 i Ligjit për punë të bashkuar i vitit 1976, parashikon se pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet .

AKP-ja, pretendon në kundërshtimin e vetë se Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar informacione dhe prova shtesë dhe i pa dërguar Z. A më dt. 16 maj 2013, një letër duke i kërkuar informacione

shtesë dhe dëshmi mbështetëse. Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar pranë AL një kopje të listës së pagave që pretendon se nuk janë paguare për periudhën janar 2006 deri në janar të viti 2007, të nënshkruar nga llogaritari dhe drejtori.

AL ka kryer verifikime të mëtejshme në lidhje me kërkesën në përputhje me nenin 18 të Ligjit për AKP dhe më dt. 22.05.2013, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit për periudhën janar 2006 deri në dhjetor të vitit 2007. Më dt. 23 maj Banka Ekonomike ka dorëzuar pranë AKP-së, përgjigjen me historikun e llogarisë së klientit për periudhën e kërkuar nga e cila rezulton se parashtruesi i kërkesës është paguar për periudhën e pretenduar për muajin janar, mars, dhe prill 2006, në masën 80 %, të pagës neto. Për sa i përket muajve maj, qershor, korrik, gushtë, shtator, dhe tetor 2006, është paguar plotësisht. Për muajin janar 2007 nuk figuron në listën e pagave.

Bazuar në arsyet si më lartë AL konsideron se kërkesa në fjalë si pjesërisht e vlefshme ka aprovuar shumën 22,84, ( 20 % e pagës ). Kjo shumë përben vlerën neto të pagueshme ndaj kërkuarit pasi pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributi pensional janë mbajtur në momentin e pagesës së vlerës së 80 % të rrogës. Bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së ligjit nr. 04/L-034, AL vjen në përfundim se pjesa tjetër e kërkesës së paraqitur mbeti e pa provuar plotësisht, pas kërkesës për dokumente plotësueses, prandaj vendosi ta refuzoi.

Ka bashkangjitur provat :

- Formularin e kërkesës kreditore, për 13 paga nga 248€, në shumën 3,224.00€,
- Njoftimin e datës 22.05.2007,
- Kërkesa e AKP-së, për paditësit dt. 16.05.2013,
- Vendimin e AL PRN 032- 0226.

### **Arsyetimi Ligjor**

#### **Padia e paditësit, është e bazuar.**

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, ka konstatuar jo kontestuese se paditësi ishte punëtorë i të paditurës NSH “ Magjistrala ” në likuidim, sipas provës materiale njoftim të lëshuar nga AKM-ja më dt. 22.05.2007, me të cilin ju është përfunduar punësimi paditësit, sikundër edhe me librezë të punës kur ju është mbyllur librezja e punës më dt. 13.04.2007. Në rastin konkret librezja e punës është mbyllur një muaj ditë më herët para dorëzimit, të njoftimit për përfundimin e punësimit. Si kontestuese është baza juridike e kërkesës

Gjykata, me provën e dokumentit njoftimit për pushimin e marrëdhënies së punës, dt. 22 maj 2007, të lëshuar nga AKM -ja, ka vërtetuar faktin se paditësit S S i ka pushuar marrëdhënia e punës dhe se NSH -ja ka hyrë në procedurën e likuidimit nga data 13 prill 2007, sipas Vendimit të Bordit të AKM-së.

Në njoftim ndër të tjera theksohet se shumica e parave, duke përfshirë të gjitha rrogat e pa paguara, të cilat ende ua ka borxh Punëdhënësi, sipas kontratës suaj të punësimit, do të trajtohen në përputhje me procedurat e likuidimit dhe bashkangjitur e keni formularin e kërkesave të cili ju lusim ta kompletoni dhe ta dorëzoni në Komisionin e Likuidimit.

Me provën e dokumentit në kopje të Listës së pagave për periudhën janar të vitit 2006, deri në janar të vitit 2007, e nënshkruar nga personat, në cilësinë e llogaritarit dhe në cilësinë e drejtorit, provohet se në këtë listë për NJP në Gjilan është i regjistruar edhe paditësi S S në numrin rendor 22, ndërsa në këtë listë janë të përfshirë 27 punëtor . Sipas kësaj liste, paditësit për muajin janar të vitit 2006, ju është llogaritur paga bruto, në shumën 297.44€, tatimi në shumën 13.12€, trusi pensional 14.87€, trusti pensional 14.87 €, ndalesa për anëtarësi në sindikatë 6.45€, dhe ka mbetur paga neto 248.00€ . Kështu është llogaritur paga deri në muajin janar të vitit 2007, pas muajit janar, në muajin shkurt 2007, paditësi nuk ishte në listë, në listë të pagave ishte vetëm Z S e që në muajt tjerë ky punëtor figuron në listë me nr. 25.

Me provën e formularit të kërkesës kreditore, paditësi kërkesën kreditore e ka dorëzuar te Autoriteti i Likuidimit për pagat e pa paguara në shumën 3,224.00€, në të cilën kërkesë ka llogaritur për 13 muaj x 248.00€ pagën mujore neto , shuma e tërësishme 3,224.00€ , por në formular nuk e ka precizuar periudhën kohore.

Me provën e dokumentit në kopje e pajisur me shenjën „ Magjistra” si njoftim i nënshkruar nga Drejtori, por që nuk është shënuar emri dhe mbiemri i tij , e i dorëzuar në AKM më dt. 16.07.2007, vërtetohet se Drejtori ka dorëzuar regjistrat e punëtorëve të cilët janë të përfshirë në të ardhurat personale, e që si regjistër përmendet edhe regjistri për NJP në Gjilan ku në këtë regjistër është i përfshirë edhe paditësi .

Me provën e deklaratës nën betim të nënshkruar nga Sh P si drejtor i NSH „ Magjistrala ” dhe A K si llogaritar e cila është dhënë para noterit B Z. Xh , LRP 5398/2021, dt. 01.10.2021, sipas të njëjtëve në cilësinë e drejtorit dhe të llogaritarit, të njëjtit kanë hartuar dhe llogaritur dhe nënshkruar listat e pagave për punëtorët deri në ditën e Likuidimit dt. 13.07.2007. Të njëjtit janë deklaruar se kanë qenë persona zyrtar dhe e kemi përfaqësuar ndërmarrjen para Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe i kemi nënshkruar listat e pagave të pa paguara për periudhën e vitit 2005 deri në vitin 2007 të gjitha NJP të Magjistratës , për Drejtorin në Prishtinë, Pejë, Prizren, Shtime, Caralevë, Mitrovicë dhe Gjilan dhe të njëjtat i kemi dorëzuar në AKM, me nr. regjistri 21, dt. 16.07.2007, të cilën shkresë e ka nënshkruar drejtori Sh P.

Me dokumentin kontratë të punës të lidhur në mes Sha Magjistrala dhe Sh P për periudhën prej dt.01.12.2005 deri më dt. 01.12.2006, të njëjtit ju është vazhduar kontrata e punës në pozitën e drejtorit .

Me dokumentin Referencë e protokolluar nga Magjistrala, me nr. 22, dt. 16.07.2007, të nënshkruar nga A B, vërtetohet se Sh P, me profesion inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, prej dt. 01.01.2006 deri më dt. 13. 04 2007, ka qenë si Kryetar i këshillit drejtues dhe drejtor i përgjithshëm i Magjistrales.

Me regjistrin e punëtorëve të SHA „Magjistrala” në Prishtinë, dt. 13.04.2007, ky regjistër përfshin 229 punëtorë , është nënshkruar më dt. 16.09.2009, nga A B, G H dhe Sh P, në të cilën gjendet edhe paditësi S S, me nr. Rendor 41, sipas të cilit paditësi i lindur më dt. 17.10.1970, ka qenë në punë prej dt.06.08. 2001, deri më dt. 13.04.2007, dhe ka përvojë pune 5.08 vjet .

Sipas Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN 032- 0266, dt. 31.05.2013, është pranuar pjesërisht kërkesa e S S , në shumën 22.84€, ndërsa është refuzuar kërkesa në shumën 3,201.16€ .

Nga përmbajtja e arsyetimit të Vendimit të AL nuk është sqaruar pjesa e pranuar e kërkesës në shumë 22.84€ për periudhën dhe mënyrën e llogaritjes së shumës së aprovuar, dhe për këtë pjesë AL thirret nga të dhënat e siguruara më dt. 23.05.2013, të Bankës Ekonomike që është përfaqësuar nga I A në cilësinë e drejtorit pra mënyra e llogaritjes është shumë e pa qartë dhe AL në parashtrësë të mbrojtjes nuk ka dorëzuar asnjë provë se kush e bëri llogaritjen dhe në cilat kritere mbështet kjo llogaritje, për cilën periudhë kohore, dhe në cilat prova është mbështetur .

Në pjesën e refuzimit të kërkesës në shumën 3,201.16€, është arsyetuar me pretendim se kjo pjesë nuk ishte e provuar nga paditësi me dëshmi dhe informata.

Gjykata vlerëson se AL , i ka të gjitha të dhënat dhe dokumentet nga arkivi i punëtorëve, në NSH, dhe në bazë të tyre ka pasur mundësin të vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe pastaj të vendos .

Gjykata duke marre për bazë nenin 31.5, të Ligjit nr. 06/L-086, në lidhje me pohimin e faktit se paditësi gjendet në listën e punëtorëve që nuk ju janë paguar pagat e pretenduara, bazuar në provat e dorëzuara si lista e pagave, për periudhën janar të vitit 2006 deri në janar të vitit 2007, vërtetoi faktin se paditësi ishte në listën e pagave, e të cilën listë e kanë nënshkruar Sh P dhe A K, si persona kompetent të NSH –së.

E paditura nuk ka dorëzuar asnjë provë me të cilën do të kundërshtonte besueshmërinë e dokumentit të listës së pagave të pa paguara si më lartë, sipas nenit, 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 .

Gjykata vlerëson, Autoriteti i Likuidimit me rastin e marrjes së vendimit PRN 032- 0266, dt. 31.05.2013, me të cilën ka pranuar një pjesë të kërkesës për paga të pa paguara në shumën 22.845€, kurse ka refuzuar si të pavlefshme pjesën tjetër të kërkesës në shumën 3,201.16€, ajo në vendim nuk ka sqaruar pjesën e aprovuar mbi mënyrën e llogaritjes së shumës si të aprovuar ashtu edhe të refuzuar , dhe se në pjesën refuzuese edhe ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, duke zbatuar dispozitën e nenit 36.2.2 të Ligjit nr. 04/L-034 . Gjykata, AKP-së – AL, ja dha mundësin që të sqarohet edhe me përgjigje në ankesë kundër Vendimit të AL PRN 032- 0064, por e njëjta nuk dha sqarime që argumentojnë pretendimet e veta me prova materiale .

Gjykata vlerësoi se kërkesa e paditësit në formular të kërkesë kreditore për paga të papaguara në shumën mujore neto 248.00€, është në përputhje e listën e pagave për periudhën si në lista të pagave, ashtu që si me vendim ashtu edhe me përgjigje në mbrojtje, nga e paditura kjo shumë e pagës nuk është kundërshtuar.

Gjykata bazuar në provat të cilat i ka dorëzuar paditësi, si njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e pagave të pa paguara për periudhën kontestuese dhe në deklarimin nën betim të ish personave përgjegjës dhe me kompetencë të NSH të dhënë para noterit B Z. Xh, ka vërtetuar një gjendje faktike tjetër, sipas të cilës paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te i padituri deri në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës për shkak të privatizimit të NSH Magjistratja dhe se edhe për periudhën janar të vitit 2006 deri në janar të vitit 2007, paditësit nuk ju janë paguar pagat e kërkuara në shumën e përgjithshme neto, 3.224.00€ .

Gjykata pasi vërtetoi një gjendje tjetër faktike, vendosi ta ndryshoi Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN 032- 0266, dt. 31.05.2013, dhe ta pranoi kërkesën e paditësit pjesërisht si në diapozitiv.

Me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për pagimin e pagave, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, me të cilën është parapara „kërkesat e pasiguruara , kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë ” .

Me rastin e caktimit të kamatës 10 % të vlerës së shumës themelore, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 37, par 3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 me të cilën është parapara „ Të gjitha kërkesat ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit , me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10 %, të shumës themelore ” .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në diapozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 63, të Ligjit për Dhomën e Posaçme , e paditura detyrohet që paditësit t' ia, paguaj shpenzimet e procedurës në shumën 124.00€, dhe atë për padi 104.00€, dhe për taks gjyqësore 20.00 €.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva  
Gjyqtar